



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 249 Prot.

Tiranë, më 27.02.2026

VENDIM
Nr. 38, Datë 27.02 2026

PËR
“MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË KONTROLLIN E LARTË
TË SHTETIT PËR VITIN 2026”

Në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” të ndryshuar, neni 18, ligjit nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 25, si dhe Vendimit nr. 19, datë 31.01.2022, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Për strukturën e renditjes së punëve, klasifikimin e vendeve të punës dhe nivelin e pagave në KLSH” të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Miratimin e Planit Vjetor të Pranimi në Kontrollin e Lartë të Shtetit me numër total 27 vende vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2026 në pozicione pjesë e shërbimit civil.
2. Vendet vakante janë përkatësisht:
 - Nëpunës Civil në nivelet drejtuese 3 vende;
 - Nëpunës civil pjesë e trupës audituese dhe drejtorive mbështetëse 24 vende.
3. Referuar juridiksionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit formimi dhe edukimi i individëve që do të rekrutohen nuk do të ketë kufizime por kryesisht do të përfshijë drejtimet si vijon:
 - Shkenca juridike;
 - Shkenca ekonomike;
 - Shkenca ekonomike/juridike;
 - Shkenca kompjuterike;
 - Shkenca shoqërore;
 - Shkenca sociale;
 - Histori-filologji;
 - Veterinari;
 - Agronomi;
 - Shkenca biologjike dhe të ngjashme me to;
 - Kimi;
 - Shkenca mjedisore ose të tjera të përshtatshme;

- Shkenca inxhinierike;
 - Arkitekturë;
 - Arkeologji dhe restaurime;
 - Gjeodezi;
 - Shkenca ekzakte;
 - Shkenca edukimi;
 - Etj.
4. Procedurat për plotësimin e këtyre vendeve vakante do të zhvillohen në vijimësi duke iu referuar kuadrit ligjor për nëpunësin civil, ligjit nr. 154/2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” dhe politikave të brendshme për menaxhimin e burimeve njerëzore.
5. Njoftimet e detajuara për vendet vakante do të publikohen rast pas rasti në faqen e internetit në KLSH <https://www.klsh.org.al/> dhe në Portalin Kombëtar të Punësimit <https://www.puna.gov.al/>.
6. Të rekrutuarit nëpërmjet procedurave të përcaktuara nga legjislacioni për nëpunësin civil, do të emërohen në departamentet e auditimit dhe drejtoritë mbështetëse rast pas rasti në varësi të politikave të brendshme për menaxhimin e burimeve njerëzore të KLSH-së, si dhe nevojave që ka secili departament apo drejtori për realizimin e planit vjetor të auditimeve dhe përmbushjen e detyrave funksionale.

KRYETAR

Arben Shehu

